

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6817
E shtunë, 4 shkurt 2023
çmimi 0.40 €

Osmani lbon në Islandë
për anëtarësimin
e Kosovës në Këshillin
e Evropës | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA) INSISTOJNË PËR THEMELIMIN E ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE | FAQE 4-5

ESCOBARI: E PRANON OSE JO KURTI, ASOCIACIONI DUHET TË ZBATOHET



Emisari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, është duke insistuar për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Ai ka thënë se ky Asociacion duhet të themelohet, e pranon ose jo kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Sipas tij, themelimi i këtij Asociacioni është parakusht për të ecur përpara në procesin e normalizimit të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në këtë kontekst, Escobari ka përsëritur se Asociacioni s'do të jetë një Republika Srpska dhe do të jetë në përputhje të plotë me ligjet e Kosovës

POLICËT DEMANTOJNË QEVERINË: MË SHUMË NA I ULËN SESA NA I RRIJN PAGAT



Policët e Kosovës ka thënë se janë të pakënaqur me pagat e reja që priten t'i marrin nga ky muaj. Drejtuesi i Sindikatës së Policisë së Kosovës, Imer Zeqiri, ka thënë se me koeficientet e rinj qeveria ka bërë

rritje minimale të pagës bazë, prej 20 deri në 60 euro, për disa kategori brenda policisë. Por, në anën tjetër, ka thënë se janë ulur shumë paga. "Te shumica e kategorive, qoftë te hetimet, qoftë te njësitë e

specializuara apo kategoritë e tjera, te një numër i konsiderueshëm, ka zbritje, nuk ka ngritje të pagës. Tek ata që ka ngritje, ngritja më e madhe mund të jetë deri në 50-60 euro", ka thënë Zeqiri | FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

AKTUALE



HOXHAJ EMËROHET ANËTAR I BORDIT NË "VIENNA CONGRESS" | F. 3

TAHIRI KËSHILLON KURTIN: KËRKO LETËR GARANCIE PËR ASOCIACIONIN NGA SHBA-ja DHE BE-ja | F. 5

AHMETI GODET MICKOSKIN: NUK SHKOVA NË HAGË SEPSE LUFTA IME ISHTE E DREJTË | F. 3

EKONOMI



ABDIXHIKU: KOEFICIENTI I QEVERISË NUK MBULON AS PËR SË AFËRMI INFLACIONIN REKORD NË KOSOVË | F. 8

SPSPK-JA KËRKON NGA QEVERIA TA ÇAKTOJË PAGËN MINIMALE PËR SEKTORIN PRIVAT | F. 8

SPORT



DY NDESHJE SOT, DY NESËR NË SUPERLIGËN E BASKETBOLLIT | F. 10

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

NATO: Rusia t'i përmbahet Traktatit për reduktimin e armëve bërthamore

BRUKSEL, 3 SHKURT - NATO i bëri thirrje Rusisë t'i përmbushë detyrimet e saj në bazë të Traktatit për reduktime të programeve bërthamore të quajtur START. "Ne shohim me shqetësim se Rusia ka dështuar t'i përmbushë detyrimet ligjore, përfshirë inspektimin (për programet bërthamore) dhe i bëj thirrje Rusisë t'i përmbushë detyrimet e saj sipas traktatit", ka shkruar në "Twitter" sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg.

Edhe Departamenti Amerikan i Shtetit ka thënë se Rusia po shkel Traktatin e ri START, i cili kufizon numrin e mbushjeve bërthamore që mund të dislokojnë Shtetet e Bashkuara dhe Rusia përmes raketave tokësore, detare dhe bombarduesve.

ShBA-ja ka thënë se Rusia nuk

po lejon inspektimin e objekteve të saj, siç e kërkon Traktati.

Zëdhënësi i Departamentit amerikan të Shtetit, Vedant Patel, ka thënë se Rusia mund të "rikthehet lehtësisht" te zbatimi i marrëveshjes. "Ekziston një rrugë e qartë për kthimin (te marrëveshja). Ajo që Rusia duhet të bëjë është t'i lejojë inspektimet në territorin e saj ashtu siç veproi për vite me radhë sipas traktatit të START dhe të marrë pjesë në takimin e komisionit konsultativ dypalësh. Asgjë nuk i pengon inspektorët rusë që të vijnë në Shtetet e Bashkuara dhe t'i zhvillojnë inspektimet", ka thënë Patel.

Zyrtarët rusë i kanë fajësuar Shtetet e Bashkuara për mbështetjen që Uashingtoni i ka dhënë Kievit teksa Ukraina përballet me agresionin rus.



Richard Weitz, drejtor i Qendrës për Analiza Politiko-Ushtarake në Institutin Hudson, i ka thënë "Zërit të Amerikës" se ka disa arsye se pse Moska mund të jetë duke shkëlur Traktatin. "Në rastin më të mirë, Rusia po

përpiket të kërkojë lëshime të tjera nga Shtetet e Bashkuara, ndoshta të inspektojë më shumë sisteme amerikane. Në rastin më të keq, Rusia po mban peng procesin e kontrollit të armëve strategjike karshi

agresionit të saj në Ukrainë", ka thënë Weitz.

Rusia nuk ka përjashtuar përdorimin e armëve taktike bërthamore në Ukrainë, çka ka ushqyer frikën globale për një katastrofë bërthamore. /Rel/

Dhoma e Përfaqësuesve përjashton demokratën Ilhan Omar



UASHINGTON, 3 SHKURT - Republikanët në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që tani kanë shumicën në Dhomën e Përfaqësuesve, kanë përjashtuar demokratën Ilhan Omar nga Komisioni i Marrëdhënieve me Jashtë si pasojë e komenteve të saj që janë cilësuar si antisemite. Argumenti për përjashtimin e Omarit kishte të bënte me disa komente që ajo shkroi në vitin 2019 përmes një postimi në "Twitter", ku kishte thënë se "lobi izraelit në politikën amerikane

është i motivuar nga paratë dhe jo nga parimet".

Omar dhe demokratët e tjerë kanë thënë se komentet ishin bërë vite më parë dhe se ajo i ka fshirë postimet dhe ka kërkuar falje në atë kohë. "Udhëheqja dhe zëri im nuk do të dobësohen nëse nuk jam në këtë komision. Zëri im do të bëhet gjithnjë e më i fortë", ka thënë Omar pak para se të përjashtohej.

Kjo masë vjen dy vjet pasi demokratët përjashtuan dy republikanë nga komisioni.

Përjashtimi nga Komisioni, i udhëhequr nga kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve, Kevin McCarthy është konsideruar si "hakmarrje" nga demokratët.

Në vitin 2021 demokratët kishin përjashtuar republikanët Marjorie Taylor Greene dhe Paul Gosar nga komisionet pas disa komenteve që kishin të bënin me vaksinat kundër Covid-19 dhe video të shpërndara në rrjete sociale që simulonin vrasjen e një anëtareje demokrate.

Macroni paralajmëron për "pasoja" nga programi bërthamor i Iranit

PARIS, 3 SHKURT - Presidenti francez Emmanuel Macron ka kritikuar "nxitjen e shpejtë" të programit bërthamor të Iranit pas bisedimeve me kryeministrin izraelit Benjamin Netanyahu, i cili ishte në Paris për të kërkuar një qëndrim më të fortë evropian kundër Teheranit më 2 shkurt.

Në një deklaratë të lëshuar pas një takimi darke në Pallatin Elysee, Macroni paralajmëroi se vazhdimi i programit bërthamor nga ana e Iranit "do të kishte pasoja të pashmangshme".

Izraeli e ka akuzuar prej kohësh Iranin se kërkon të prodhojë armë bërthamore, ndërsa Teherani këmbëngul se programi i tij bërthamor synon vetëm prodhimin e energjisë. Netanyahu shpreson se roli i

Iranit në furnizimin me dronë për Rusinë në luftën e saj në Ukrainë, si dhe shtypjen që vendi po ua bënë protestuesve në vend, do t'i shtyjë aleatët perëndimorë të heqin dorë nga çdo ringjallje e marrëveshjes së programit bërthamor të vitit 2015.

Franca pajtohet se nevojitet "qëndrueshmëri" në marrëdhëniet me Iranin, ka thënë një burim diplomatik për agjencinë e lajmeve "AFP", duke shtuar se programi bërthamor i Iranit ka arritur në "një pikë të rrezikshme".

Izraeli nuk e refuzon dërgimin e ndihmës ushtarake në Ukrainë, ka thënë kryeministri Benjamin Netanyahu në një intervistë për "CNN".

Netanyahu ka thënë se "padyshim është duke e



konsideruar" ofrimin e mbështetjes ushtarake për Kievin. Ai ka thënë se Izraeli është i gatshëm të dërgojë në

Ukrainë sistemin e mbrojtjes kundër raketave Iron Dome. Mirëpo, qëndrimi përkrahës i tij për Ukrainën nuk është pa

rrezik për Izraelin, pasi mbrojtja ajrore ruse e vendosur në Siri mund të kthehet kundër avionëve izraelitë.

Netanyahu, i cili është rikthyer në pushtet në shtator të vitit të kaluar, ka thënë se ai do të ishte i gatshëm të vepronte si ndërmjetës në negociatat midis Rusisë dhe Ukrainës, nëse të dyja palët dhe Shtetet e Bashkuara bien dakord.

Lufta në Ukrainë ka filluar më 24 shkurt të vitit 2022. Presidenti rus Vladimir Putin e ka quajtur luftën një "operacion special ushtarak" për çmilitarizimin e Ukrainës. Përditimi i është përgjigjur Rusisë me sanksione të ashpra. Si rezultat i luftës në Ukrainë, mijëra njerëz kanë vdekur, ndërkaq miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

LDK-ja zyrtarisht bojkoton RTK-në



PRISHTINË, 3 SHKURT (ER) - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) zyrtarisht ka bojkotuar praninë në Radio Televizionin e Kosovës (RTK) deri në anulimin e procesit të përzgjedhjes së drejtorit të këtij televizioni. LDK-ja ka vlerësuar se përzgjedhja e një aktivisti politik në krye të kanaleve shqip në RTK është kapje e plotë e këtij institucioni publik i cili po shndërrohet në mjet propagande për pushtetin. "LDK-ja ka reaguar rreth kësaj përzgjedhje dhe deri në anulimin e këtij

procesi me të gjitha strukturat e saj udhëheqëse do ta bojkotojë prezencën në këtë kanal publik", është thënë në reagimin e LDK-së. Kjo parti, po ashtu, u bënë thirrje të gjithë akterëve të tjerë, subjekteve politike e organizatave vendore e ndërkombëtare si dhe figurave të pavarura, që të ndjekin një hap të tillë. "LDK-ja solidarizohet me gazetarët dhe të gjithë punëtorët që kanë punuar shumë dhe kanë informuar të gjithë qytetarët tanë drejt dhe në

mënyrë të pavarur. Qytetarët e Kosovës meritojnë një televizion publik të pavarur. Prandaj, LDK-ja edhe njëherë kërkon anulimin e menjëhershëm të përzgjedhjes në fjalë, dhe derisa sa kjo të ndodhë, LDK-ja nuk do të marrë pjesë në asnjë emision, apo format që organizohet nga ky transmetues", është thënë në reagimin e LDK-së. Në krye të RTK-së drejtor është vendosur militanti i Vetëvendosjes dhe njeriu i afërt me pushtetin, Rilind Gërvalla.

Osmani lobon në Islandë për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës

REYKJAVIK, 3 SHKURT (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në kuadër të vizitës në Islandë, të premten ka takuar disa nga përfaqësuesit e këtij shteti. Fillimisht ajo është takuar me kryetarin e Kuvendit të Islandës, Birgir Armannsson. Në këtë takim Osmani ka falënderuar Islandën për mbështetje ndaj Kosovës dhe ka folur për përkushtimin e Kosovës që ky bashkëpunim të shtohet. Presidentja Osmani dhe kryetari i Kuvendit të Islandës kanë biseduar edhe mbi rëndësinë e bashkëpunimit ndërparlamentar. Po ashtu, Osmani ka folur edhe mbi zhvillimet e fundit në Kosovë. Presidentja ka thënë se institucionet e Republikës

vazhdojnë të jenë të përkushtuara për sundim të ligjit dhe avancim të demokracisë, vlerësuar edhe në indekset e fundit ndërkombëtare, ku Kosova ka shënuar përparim të jashtëzakonshëm. Në anën tjetër, i pari i Kuvendit islandez ka deklaruar përkushtimin e këtij shteti për thellimin e raporteve midis dy popujve dhe shteteve. Pas këtij takimi, presidentja Osmani është takuar edhe me ministren e Punëve të Jashtme të Islandës, Thordis Kolbrun Reykfyrd Gylfadottir. Në takim me ministren islandeze është rikonfirmuar gatishmëria e dy vendeve për thellimin e bashkëpunimit ndërshtetëror në politikën e jashtme.



Presidentja Osmani ka shprehur gatishmërinë për rritjen e bashkëpunimit dhe kontakteve përgjatë presidencës islandeze të Këshillit të Evropës (KE), duke ritheksuar përkushtimin e palëkundur të Kosovës për

promovimin e të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit dhe demokracisë. Ajo ka përmendur rëndësinë e madhe që ka për qytetarët e Kosovës avancimi tutje i anëtarësimin të Kosovës në këtë

organizatë, duke thënë se Kosova është mishërim i vlerave që përfaqëson Këshilli i Evropës (KE). Ndër të tjera, presidentja Osmani dhe kryediplomatja islandeze kanë diskutuar për situatën aktuale në rajon, Evropë dhe më gjerë, si dhe për nevojën për të qëndruar të bashkuar kundër aktorëve antidemokratikë, të cilët kanë qëllim destabilizimin dhe kërcënimin e vlerave tona të përbashkëta liridashëse. Presidentja Osmani ka theksuar rëndësinë e avancimit të rrugës euroatlantike të Kosovës, duke përmendur hapat e ndërmarra për përafrim me BE-në dhe NATO-n, si dëshmi e vendosmërisë së palëkundur të popullit të Kosovës për këtë proces.

Ahmeti godet Mickoskin: Nuk shkova në Hagë sepse lufta ime ishte e drejtë



TETOVË, 3 SHKURT - Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, është thumbuar sërisht me kryetarin e VMRO-DPMNE-së, Hristjan Mickoski, për luftën e vitit 2001 në Maqedoni. Ahmeti ka thënë se Mickoski ka nxjerrë vetëm një foto me kallash në "Facebook" nga lufta e vitit 2001. Ai ka thënë se kryetari i VMRO-DPMNE-së, përveç asaj fotoje, nuk ka gjë tjetër, ndërsa për vete ka thënë se ka një marrëveshje të firmosur nga NATO-ja, ShBA-ja dhe BE-ja. "Del Mickoski dhe thotë Ali Ahmeti ka humb luftën. Po çfarë lufte ka humbur Ali Ahmeti? Me marrëveshje

ndërkombëtare të garantuar, të nënshkruar nga NATO, Amerika dhe Evropa", ka thënë Ahmeti në një tubim në Zhelinhë të Tetovës. Më tutje, ai ka thënë se lufta e tij ishte e drejtë. "Dhe unë nuk shkova në Hagë, sepse lufta ime ishte e drejtë. Dhe po më del me kallash po më përgjigjet mua. Pse i thash unë, me që e ka marrë si ofenduese se unë nuk i thash televizor po 'televizi' si pleqtë e plakat që i thonë, e ka parë luftën. Po vërtetë ashtu e ka parë, se veç një fotografi e nxori me kallash, tjetër nuk ka. Po unë kam marrëveshje ndërkombëtare të nënshkruar", ka thënë Ahmeti.

Hoxhaj emërohet anëtar i bordit në "Vienna Congress"

VJENË, 3 SHKURT - "Vienna Congress", një kongres i cili një herë në vit mbledh politikanë, shkencëtarë, diplomatë nga e tërë bota, pas vdekjes së Erhard Buseck, ka plotësuar bordin me një emër nga Kosova. Pasues i Erhard Buseck në bordin e Kongresit të Vjenës

do të jetë ish-ministri i jashtëm, tani nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Enver Hoxhaj. Bordi i Kongresit të Vjenës përbëhet nga emra të politikës, shkencës e diplomacisë botërore. Mirëseardhje në bord Hoxhaj i ka dëshiruar ish-presidenti

çek Vaclav Klaus, i cili momentalisht udhëheq këtë bord dhe bartësi i çmimit Nobel për kimi, ish-kandidati për president të Izraelit. Dan Shechtman. Kongresi i Vjenës mbahet çdo fillimvit dhe përpiqet ta mbajë vazhdimësinë e Kongresit të Vjenës nga viti 1814.





SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA) INSISTOJNË
PËR THEMELIMIN E ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE

Escobari: E pranon ose jo Kurti, Asociacioni duhet të zbatohet

Emisari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, është duke insistuar për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Ai ka thënë se ky Asociacion duhet të themelohet, e pranon ose jo kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Sipas tij, themelimi i këtij Asociacioni është parakusht për të ecur përpara në procesin e normalizimit të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në këtë kontekst, Escobari ka përsëritur se Asociacioni s'do të jetë një Republika Srpska dhe do të jetë në përputhje të plotë me ligjet e Kosovës

PRISHTINË, 3 SHKURT - Zëvendës-ndihmëssekretari amerikan dhe emisari për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka folur për dialogun Kosovë - Serbi si dhe për zhvillimet në Kuvendin e Serbisë, ku të enjten ka pasur përplasje për çështjen e Kosovës dhe planin franko-gjerman. Për planin franko-gjerman Escobari ka thënë se është "një udhërrëfyes i mrekullueshëm" dhe se shpreson që të dyja palët e pranojnë dhe fillojnë menjëherë zbatimin e tij. Më tutje, Escobari e ka vënë theksin tek Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe, për të cilin ka thënë se duhet të zbatohet. "Por, ndërkohë, ka mjaft fusha që ekzistojnë brenda Marrëveshjes së Brukselit që

mbeten të paplotësuara. Një nga më të rëndësishmet është Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe", ka thënë ai. Megjithatë, Escobari nuk ka treguar nëse pika për Asociacionin është e përfshirë në planin franko-gjerman, duke thënë se mund të zbulojë por, sipas tij, është një dispozitë që Kosova dhe Serbia duhet t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e kaluara. Ai ka pasur edhe një koment për refuzimin e kryeministrit Albin Kurti për Asociacionin, edhe pse ai të enjten ka paraqitur gjashtë kushtet për pranimin e tij. "Sido që shkoni përpara në dialogun e lehtësuar nga BE-ja, do të keni një Asociacion (të Komunave me

Shumicë Serbe). Prandaj them gjithmonë se do të zbatohet në një moment. E pranon ose jo Qeveria aktuale në Kosovë obligimin ligjor, nuk është marrëveshje në mes të Kurtit dhe Serbisë. Është një marrëveshje në mes të Serbisë dhe Kosovës. Kjo është arsyeja pse unë vazhdoj të them se do të ndodhë. Do të jetë baza e marrëveshjes së normalizimit. Nuk mund të mos bëhet kjo", ka thënë Escobari për gazetën "The Pavlovic Today". Në pyetjen e gazetës se çfarë ka kaq specifike dhe urgjente tani për zbatimin e Asociacionit, Escobari ka përmendur dy arsye si më kryesoret. "Ajo që është specifike dhe urgjente tani është një: gjatë një viti e gjysmë të fundit ne kemi parë një seri konfrontimesh në rritje midis Serbisë dhe Kosovës, të gjitha të përqendruara rreth trajtimit të serbëve në veri dhe mënyrës se si ata ndërveprojnë me Qeverinë e Kosovës. Pra, një, ne duhet ta thyejmë ciklin e konfrontimeve dhe konflikteve gati të dhunshme", është përgjigjur Escobari. Faktori tjetër që e bën formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe një pikë urgjente në agjendën amerikano-

evropiane është lufta e vazhdueshme në Ukrainë. "Ajo që do të na ndihmojë të zgjidhim këtë konflikt do të jenë dy gjëra: uniteti ShBA - BE dhe solidariteti i NATO-s. Pra, ne nuk mund ta harxhojmë kapacitetin e brezit tonë në konflikte brenda territorit të Evropës", ka thënë Escobari, duke shtuar se Asociacioni është vendimtar për të ecur përpara. "Evropa duhet të jetë e lirë, paqësore dhe e bashkuar ndërsa përballemi me kërcënime reale të sigurisë jashtë kontinentit, jashtë hapësirës sonë transatlantike. Kështu që ne duhet ta bëjmë atë. Dhe kështu, në kontekstin e kësaj, gjermanët dhe francezët propozojnë këtë udhërrëfyes, të cilin ne e mbështetim plotësisht. Në atë udhërrëfyes dhe në kontekstin e krizës, ku serbët u larguan (nga institucionet), urgjenca, nevoja për zbatim, Asociacioni (i Komunave me Shumicë Serbe) është absolutisht vendimtar për të ecur përpara", ka deklaruar Escobari. Ai ka përsëritur se Asociacioni s'do të jetë një Republika Srpska dhe se do të jetë në përputhje të plotë me ligjet e Kosovës. "Pra tani brenda këtij konstrukti, qëndrimi ynë është që duhet të jetë diçka që nuk e shkel

Kushtetutën e Kosovës, sipas ligjeve të Kosovës, që nuk krijojnë probleme për funksionalitetin e Kosovës. Me fjalë të tjera, asnjë model i Republika Srpska. Tani, ajo që bën, për mendimin tim, është se e ndihmon Kosovën t'i marrë përsipër shërbimet dhe çështjet që serbët në veri aktualisht kërkojnë nga Beogradi t'i bëjë - do të transferohet, të gjitha ato shërbime duhet të ofrohen nga qeveria dhe Kosova. Dhe nëse Serbia ka ndonjë zë në të, kjo duhet të bëhet në mënyrë transparente dhe sipas ligjeve të Kosovës. Pra, ky është vizioni ynë. Çfarë do të bënte kjo? Do t'u ofronte këtyre komunave aftësinë për të koordinuar dhe krijuar ekonomi të shkallës për gjëra të tilla si arsimit, kujdesi shëndetësor, të gjitha në gjuhën serbe, heqja e mbeturinave, shërbimet e ambulancës, llojet e gjërave që komunat tashmë i bëjnë, por ato do të jenë në gjendje të koordinohen mes tyre për ta bërë atë të funksionojë për ta. Dhe nga mënyra, siç e bëjnë ata, duhet të jetë pa probleme. Njerëzit nuk duhet të ndiejnë ndonjë ndryshim në jetën e tyre ose ndonjë ndryshim negativ në jetën e tyre ndërsa ne ecim përpara në këtë drejtim", ka thënë

BE-ja: Kosova ta formojë Asociacionin

BRUKSEL, 3 SHKURT - Bashkimi Evropian (BE) ka përsëritur kërkesën e tij që Kosova ta formojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. I pyetur nga "Radio Evropa e Lirë" për kushtet e vendosura nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, për themelimin e Asociacionit, zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, ka thënë se blloku nuk i komenton "të gjitha prononcimet e të tjerëve". Ai ka thënë se përsërit "urgjencën që për BE-në ka lëvizja përpara e dialogut dhe zbatimi i marrëveshjeve të arritura, një prej të cilave është edhe ajo për Asociacionin".

Kurti, i cili deri më tani ka kundërshtuar fuqishëm krijimin e Asociacionit njëetnik, të enjten shpалosi para deputetëve të Kuvendit të Kosovës gjashtë kushtet për formimin e tij. Sipas Kurtit, Asociacioni nuk mund të jetë njëetnik, ai duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e vendit, të ketë një emër tjetër dhe të mos ketë kompetenca ekzekutive, të ketë të përfshirë parimin e reciprocitetit në mes të shteteve sa i përket të drejtave të pakicave kombëtare, bazuar në modelet evropiane.

Kurti, po ashtu, ka kërkuar që të shuhen strukturat ilegale në veri dhe të bëhet dorëzimi i armëve, si dhe Serbia t'i tërheqë letrat dërguar pesë shteteve mosnjohëse të BE-së për mospranimin e Kosovës në bllokun evropian. Kurti ka kushtëzuar themelimin e Asociacionit edhe me përfshirjen



e tij në një marrëveshje eventuale finale me Serbinë dhe të zbatohet pas njohjes së ndërsjellë.

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i ka cilësuar "përrallë" kushtet për Asociacionin. Në një seancë të Kuvendit të Serbisë, gjatë diskutimeve për Kosovën, Vuçiqi ka thënë se Kurti, në fakt, "nuk do ta formojë Asociacionin". BE-ja ka thënë disa herë se

marrëveshja e cila parasheh formimin e Asociacionit është obligim ndërkombëtar i Kosovës dhe se ajo duhet të implementohet.

Edhe ShBA-ja e ka vlerësuar prioritet kryesor formimin e Asociacionit dhe për këtë çështje ka organizuar edhe një diskutim më 31 janar.

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Jeff

Hovenier, ka thënë se vendi i tij e ka bërë të qartë tashmë se "nuk mbështet asnjë marrëveshje që shkel Kushtetutën e Kosovës" ose që "kërcënon sovranitetin, pavarësinë dhe karakterin multietnik" të saj.

Kosova dhe Serbia, nën ndërmjetësim të Bashkimit Evropian, kanë nënshkruar më 2013 marrëveshjen për formimin e Asociacionit, por ajo

nuk është zbatuar kurrë. Më 2015 është nënshkruar një marrëveshje tjetër për, siç është thënë, parimet e këtij Asociacioni.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës më 2015 gjeti se 23 pika të Marrëveshjes mbi parimet për themelimin e Asociacionit nuk ishin në harmoni me aktin më të lartë juridik të shtetit. Por, gjykata tha se ato mund të harmonizohen.

Tahiri këshillon Kurtin: Kërko letër garancie për asociacionin nga ShBA-ja dhe BE-ja



PRISHTINË, 3 SHKURT - Ish-kryenegociatorja e Kosovës në bisedimet me Serbinë, Edita Tahiri, e ka këshilluar kryeministrin Albin Kurtin që të kërkojë letër garancie nga ShBA-ja dhe BE për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Tahiri ka publikuar një letër të ngjashme që dikur ia kishte kërkuar Federica Mogherini si ndërmjetësuese e BE-së. "Pas

pranimit të asociacionit, kryeministri Kurti nuk guxon të jap kompetenca ekzekutive për asociacionin. Hapi i parë është të kërkojë një letër garancie nga ndërmjetësuesit amerikan dhe BE-së, Escobari dhe Lajçaku që më të cilën ata sigurojnë që Asociacioni nuk do të ketë kompetenca ekzekutive dhe nuk do të jetë një nivel i tretë qeverisjes në Kosovë.

Një letër të tillë unë si kryenegociatore kam arritur që ta siguroj nga Mogherini si ndërmjetësuese e BE-se me të cilën ajo ka siguruar se për BE-në asociacioni nuk ka kompetenca ekzekutive dhe nuk do të jetë nivel i tretë qeverisje në Kosovë. Ja letra e Mogherinit drejtuar Kryeministrin të Kosovës", ka shkruar Tahiri në "Facebook".

zyrtari i lartë amerikan.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të enjten në Kuvend se themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe mund të konsiderohet me disa kushte, mes të tjerash, ai "duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës".

Një tjetër kusht, sipas tij, është që Asociacioni nuk mund të jetë njëetnik. Ai "duhet ta ndërrojë emrin, nuk mund të bartë asnjë pushtet publik apo ekzekutiv dhe duhet t'i shërbejë vetëm

bashkëpunimit horizontal të komunave, sipas Kushtetutës dhe Ligjit për Vetëqeverisje Lokale". "Normalizimi i plotë i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë me njohjen reciproke në qendër të marrëveshjes duhet t'i garantojë edhe të drejtat e komuniteteve pakicë dhe mekanizmat përkatës institucionalë. Shteti normal demokratik nuk i diskriminon pakicat, por i mbron ato si vlerë themelore dhe i ruan ato si pasuri shoqërore. Normalizimi i jashtëm i marrëdhënieve duhet

t'i kontribuojë normalizimit të brendshëm të shteteve. Asociacioni i Komunave, i dalë në parim nga marrëveshja e Brukselit Thaçi - Daçiç e 19 prillit 2013, si një mekanizëm i tillë, mund të konsiderohet nga Republika e Kosovës me këto kushte: 1. Asociacioni duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës. 2. Asociacioni nuk mund të jetë monoetnik, duhet ta ndërrojë emrin, nuk mund të ketë/bartë asnjë pushtet publik (apo ekzekutiv) dhe duhet t'i shërbejë

vetëm bashkëpunimit horizontal të komunave sipas Kushtetutës dhe Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (kreu 5). 3. Të drejtat e pakicave kombëtare dhe mekanizmat mbrojtës përkatës duhet ta ndërthejnë parimin e reciprocitetit ndërmjet dy shteteve respektive si dhe t'i marrin parasysh standardet dhe modelet evropiane. 4. Para vendosjes së Asociacionit, strukturat ilegale të Serbisë në veri shuhen dhe bëhet dorëzimi i të gjitha armëve ilegale. 5. Asociacioni është pjesë e marrëveshjes finale dhe

zbatohet pas njohjes reciproke. Dhe vetëm pasi Serbia t'i ketë pranuar parimet e Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara në raportet e saj ndërshtetërore me Republikën e Kosovës. 6. Presidenti i Serbisë i tërheq letrat e dërguara te pesë shtetet anëtare të BE-së dhe tek të tjerat për mospranimin e aplikimit të Republikës së Kosovës për anëtarësim në Bashkimit Evropian, që paraqet edhe shkelje të po asaj marrëveshjeje Thaçi - Daçiç të 19 prillit 2013", ka thënë Kurti para deputetëve.

Dyfishohet numri i shtretërve në Klinikën e Psikiatrisë

PRISHTINË, 3 SHKURT (ER) - Ushtruesja e detyrës e drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (ShSKUK), Narqize Arënliu-Hoxhaj, ka vizituar Klinikën e Psikiatrisë, në të cilën së fundmi është bërë riorganizimi i reparteve dhe shtimi i kapaciteteve me shtretër.

Drejtori i kësaj klinike, Faton

Kutillovci, e ka njoftuar drejtoreshën Arënliu-Hoxhaj, se në kuadër të riorganizimit është hapur Reparti i ri i Sëmundjeve të Varësisë, me ç'rast është dyfishuar numri i shtretërve, nga gjashtë në 12 shtretër.

Sipas tij, në kuadër të ish-Repartit të Sëmundjeve të Varësisë sot është hapur Reparti i ri, që nuk ka ekzistuar më parë,

Reparti i Çrregullimeve Akute-Psikotike, i cili do të ketë gjashtë shtretër.

Ndërsa drejtoresha Arënliu-Hoxhaj ka përgëzuar stafin e klinikës për këtë riorganizim dhe për hapjen e shërbimeve të reja, duke ofruar mbështetjen dhe përkrahjen e ShSKUK-së për zgjerim dhe avancim të mëtejshëm të shërbimeve në Klinikën e Psikiatrisë.



Studimi i fizibilitetit për ngrohjen e qytetit të Drenasit, në fazën finale

DRENAS, 3 SHKURT (ER) - Nën kryetari i komunës së Drenasit, Arben Shala, së bashku me menaxherin komunal për energji, Afrim Prokshi, kanë pritur në takim përfaqësuesit e kompanisë "IPF 10 Planet", Rainer Bahnmuller, ekspertin për sistemin për energji solare, Christian Holter dhe Avni Sfishita, koordinator i projektit në kuadër të GIZ-it.

Nën kryetari Shala ka falënderuar përfaqësuesit e këtij projekti për punën dhe angazhimin e tyre për hartimin e studimit të fizibilitetit për ngrohjen qendrore të qytetit e cila është e rëndësishme për Drenasin.

Shala ka kërkuar nga përfaqësuesit e kompanisë për studimin e fizibilitetit për

ngrohjen e qytetit që ta njoftojnë se deri ku kanë shkuar fazat e përgatitjes së këtij projekti.

Ndërsa përfaqësuesit e kompanisë në fjalë e kanë njoftuar nënkryetarin Shala se studimi i fizibilitetit për ngrohje qendrore për qytetin e Drenasit është duke shkuar në fazën finale dhe janë duke i trajtuar skenarët e mundshëm për gjetjen e burimit të energjisë për këtë qëllim dhe kanë mbetur edhe përlllogaritjet e kostos së këtij projekti, pasi që ende janë në fazën e përcaktimit të llojit të burimit të energjisë që do të përdoret për këtë projekt, njëherësh kanë paraqitur skenarët e mundshëm që burim i energjisë që përdoret, të jenë kolektorët solarë si burim i



energjisë së ripërtërishme.

Pas takimit, nënkryetari Shala me përfaqësuesit e kompanisë kanë dalë edhe në terren për t'i vizituar dy lokacionet që u konsideruan mjaft të përshtatshëm për këtë qëllim dhe kostoja për ngrohje qendrore do të jetë zero e konsumit të energjisë, sepse e gjithë energjia për ngrohje do të përfitohet nga kolektorët solarë. Nën kryetari Shala ka thënë se komuna e Drenasit do t'i shikojë pronësitë e këtyre lokacioneve dhe do të konsultohet me dokumentet strategjike të komunës, me PZhK-në dhe HZK-në, pastaj do t'i njoftojë përfaqësuesit e kompanisë për ta finalizuar studimin e fizibilitetit për ngrohjen qendrore.

Haxhiu: Ata që po kërkojnë që vetëm Kosova të japë diçka, po i hyjnë në hak Kosovës



PRISHTINË, 3 SHKURT (ER) - Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka kujtuar masakrën e 3 dhe 4 shkurtit 2000, ku "Rojet e Urës" në Mitrovicë kishin vrarë 10 shqiptarë, në mesin e të cilëve fëmijë, gra dhe pleq.

Haxhiu ka shkruar se Serbia ka kryer shumë krime, teksa Kosovës nuk ia dhanë lirinë dhuratë, por atë e ka arritur me gjak dhe sakrificë. "Kur të gjithë besonin se çlirimi i Kosovës ishte kryer në

qershorin e vitit 1999, në prani edhe të forcave e misionit ndërkombëtar, tetë muaj më pas në veri të Mitrovicës popullsia shqiptare po përjetonte një tmerr tjetër. Ishte kjo nata e tmerrit e 3 dhe 4 shkurtit të vitit 2000, ku 10 shqiptarë u ekzekutuan, 1 564 familje u dëbuan nga shtëpitë e tyre dhe 11 364 persona të tmerruar, dhunshëm u detyruan të largohen për të gjetur strehim për sigurinë e jetës së tyre. Serbia ka

shkaktuar shumë krime e dëme në Kosovë. Populli i Kosovës e ka përjetuar në lëkurën e tij këtë gjë. Ata që kërkojnë gjithnjë e më shumë kompromise ku vetëm Kosova duhet të japë diçka janë duke i hyrë në hak Kosovës. Liria dhe shteti i Kosovës nuk janë dhuratë. Ato janë arritur me gjak e sakrificë. Lavdi e drejtësi për martirët e natës së tmerrit të 3 dhe 4 shkurtit!", ka shkruar Haxhiu në "Facebook".

Rahoveci kompenson bujqit që pësuan nga vërshimet

RAHOVEC, 3 SHKURT (ER) - Komuna e Rahovecit, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), pritet t'i kompensojnë 243 bujq të cilët janë dëmtuar nga vërshimet.

Kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, ka bërë me dije se paraprakisht janë kompensuar 214 bujq derisa në pritisë janë edhe 83 të cilët ka thënë se do të

kompensohen në ditët në vazhdim.

"Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të MBPZHR-së, pas shqyrtimit të ankesës së bazuar në faktet, argumentet dhe dëshmitë e ofruara prej Komunës së Rahovecit, dje i ka kualifikuar edhe 243 bujq, të cilët do të dëmshpërblehen. Sipas raportit të Drejtorisë Komonale për Bujqësi, i cili po vazhdon të shqyrtohet në

MBPZHR, përkatësisht në Komisionin për Ankesa të kësaj ministrie, nga 540 bujq që u janë dëmtuar kulturat e tyre nga fatkeqësitë natyrore, ditë më herët 214 bujq janë kompensuar, kur i shtojmë edhe 243 të kualifikuar që do të kompensohen, na mbetet ta vazhdojmë 'betejën', edhe për 83 bujq", ka shkruar Latifi në "Facebook".

Latifi ka falënderuar

Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave të MBPZHR-së për bashkëpunimin konstruktiv me Drejtorinë Komonale të Bujqësisë së Rahovecit, e cila i ka ofruar këtij komisioni dëshmi shtesë. "Po ashtu, u jam mirënjohës edhe komisioneve të komunës sonë, që kanë bërë një punë të mundimshme për regjistrimin, vlerësimin objektiv dhe përgatitjen e gjithë dokumentacionit të



nevojshëm, për t'u kompensuar bujqit e dëmtuar. Ju bëj thirrje bujqve për mirëkuptim, duke besuar se do të përfundojë ky proces në të mirën e tyre!", ka shkruar Latifi.

Policët demantojnë qeverinë: Më shumë na i ulën sesa na i rritën pagat

Policët e Kosovës ka thënë se janë të pakënaqur me pagat e reja që pritet t'i marrin nga ky muaj. Drejtuesi i Sindikatës së Policisë së Kosovës, Imer Zeqiri, ka thënë se me koeficientet e rinj qeveria ka bërë rritje minimale të pagës bazë, prej 20 deri në 60 euro, për disa kategori brenda policisë. Por, në anën tjetër, ka thënë se janë ulur shumë paga. "Te shumica e kategorive, qoftë te hetimet, qoftë te njësitë e specializuara apo kategoritë e tjera, te një numër i konsiderueshëm, ka zbritje, nuk ka ngritje të pagës. Tek ata që ka ngritje, ngritja më e madhe mund të jetë deri në 50-60 euro", ka thënë Zeqiri

PRISHTINË, 3 SHKURT - Policia e Kosovës nuk është e kënaqur me pagat e reja. Edhe pse Qeveria e Kosovës ka thënë se përmes Ligjit të ri për Paga në sektorin publik janë rritur pagat e zyrtarëve policorë, nga Policia e Kosovës kanë thënë se me ligjin e ri për disa pjesëtarë parashihet edhe ulja e pagave.

Më 1 shkurt ekzekutivi ka njoftuar se vlera e koeficientit të pagave do të jetë 105 euro. Me Ligjin e ri për Paga, niveli i koeficienteve është nga 2 deri në 18. Presidentes së shtetit i është caktuar koeficienti më i lartë, sipas të cilit, ajo do ta ketë pagën më të madhe. Rreth 83 mijë punonjës të sektorit publik marrin pagë nga buxheti i shtetit. Me koeficientet e rinj, qeveria ka thënë se synon të krijojë barazi në mesin e shërbyesve publikë. Policia e Kosovës numëron një staf prej afër 10 mijë personash. Koeficientin më të lartë e ka drejtori i përgjithshëm (14.5), kurse më të ulët (2) e kanë kadetët policorë. Besohet se pjesa më e madhe e pjesëtarëve në Policinë e Kosovës kanë pozitën polic i lartë, koeficienti i së cilës është 5.9, që përkthehet në pagë bazë prej 619 eurosh.

Drejtuasi i Sindikatës së Policisë së Kosovës, Imer Zeqiri, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se me koeficientet e rinj qeveria ka bërë rritje minimale të pagës bazë, prej 20 deri në 60 euro, për disa kategori brenda policisë. Por, në anën tjetër, ai ka thënë se janë ulur shumë paga. "Paga bazë e një polici të lartë që, për shembull, punon në NJSI (Njësia Speciale Intervenuese) është 702 euro (392 pagë bazë, plus 310 euro shtesa). E tash, më shumë është 702 apo 619 euro? Pse po e them këtë? Gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë euro është në bazë të koeficientit të ri, pjesën tjetër shtesë, te Policia e Kosovës, me Ligjin e ri të Pagave e kanë

zvogëluar, për të mos thënë e kanë hequr krejt, e kanë lënë vetëm 1 për qind të buxhetit (të Policisë së Kosovës), që nuk mbulon asgjë, e që policin e lë pa shtesa edhe për rrezikshmëri", ka thënë Zeqiri.

Ai ka thënë se te disa kategori të zyrtarëve policorë ka ulje të pagës. "Te shumica e kategorive, qoftë te hetimet, qoftë te njësitë e specializuara apo kategoritë e tjera, te një numër i konsiderueshëm, ka zbritje, nuk ka ngritje të pagës. Tek ata që ka ngritje, ngritja më e madhe mund të jetë deri në 50-60 euro", ka thënë ai.

Rritet paga bazë, por ulen shtesat

Deri më tani pagat bazë në shumicën e kategorive kanë qenë më të ulëta krahasuar me këto që i ka paraqitur Qeveria e Kosovës me Ligjin e ri për Paga. Megjithatë, zyrtarët policorë kanë marrë më shumë pagë, pasi kanë pasur edhe shtesa të tjera, si ajo e përvojës së punës, për rrezikshmëri, për punë jashtë orarit dhe për punë në ndërrimin e natës.

Ligji i ri, i paraqitur nga qeveria, rrit pagën bazë, por pritet ta zvogëlojë vlerën e shtesave, pasi aty thuhet se për këto shtesa mund të shfrytëzohet vetëm 1 për qind e buxhetit të Policisë së Kosovës. Buxheti vjetor i Policisë së Kosovës për 2023-n është mbi 115 milionë euro, ndërsa 1 për qind e këtij buxheti është 1.1 milion euro.

Ky buxhet për shtesa, sipas Zeqirit, nuk mjafton as për një muaj. Policia e Kosovës nuk i është përgjigjur kërkesës së "Radios Evropa e Lirë" për deklaratë lidhur me ndryshimin e pagave.

Deri në momentin e publikimit të këtij shkrimi Policia e Kosovës



nuk ka ofruar as të dhëna për numrin e zyrtarëve të cilët preken si nga ulja, ashtu edhe nga rritja e pagës. Përkundër kësaj, sipas Sindikatës së Policisë, dhe sipas ish-drejtorit të Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, i cili tani është deputet i PDK-së, numri më i madh i zyrtarëve policorë i takon kategorisë "polic i lartë", e cila përbëhet nga policë që kanë pesë e më shumë vjet përvojë në këtë institucion.

Qalaj ka thënë për "REL"-in se aktualisht ka konfuzion dhe se nuk dihet se si do të vendoset për çështjen e shtesave për policët.

Heqjen apo uljen eventuale të tyre, Qalaj e ka konsideruar të papranueshme.

Ndërsa deputetja e partisë opozitare, Lidhja Demokratike të Kosovës, Hykmete Bajrami, gjatë një seance plenare, të mbajtur më 2 shkurt, ka thënë se qeveria është treguar e pasinqertë me zyrtarët policorë pasi, sipas saj, atyre do t'u hiqen shtesat. "Koeficienti i pagave u caktua 105 euro, dhe qeveria doli me statistikën e saj, si gjithëherë, të pasinqerta. Qeveria dje nuk i tregoi policit të lartë që po i rritet paga për 180 euro, por atij me pagën e shkurtit nuk i paguhet më shtesa prej 180 eurosh", ka thënë ajo.

Në një reagim, pas publikimit të koeficienteve të rinj të pagave, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se ky hap, mes të tjerash, është mbështetje solide për Policinë dhe për kategoritë e tjera. "Barazi dhe ndershmëri për pagat në mes të kategorive, ngushtim të hendekut midis zyrtarëve të lartë dhe të tjerëve, si dhe mbështetje solide për katër kategoritë jetike për funksionimin e shoqërisë, atë të

mjekëve, arsimitarëve, policëve dhe ushtarakëve", kishte shkruar Kurti në "Facebook". Në Sindikatën e Policisë së Kosovës kanë thënë se qeveria nuk u ka dhënë sqarim të qartë sa i takon çështjes së shtesave për Policinë e Kosovës.

Pagë "që nuk siguron mirëqenie"

Pas publikimit pagave të reja për pjesëtarët e Policisë së Kosovës, një zyrtar i këtij institucioni, i cili nuk ka dashur të identifikohet, i ka thënë "Radios Evropa e Lirë" se paga e tij bazë është 392 euro, ndërsa me ligjin e ri paga e tij bazë pritet të jetë 619 euro bruto. Por, sipas kalkulatorit të pagës, që gjendet në uebfaqen e Administratës Tatimore të Kosovës, pasi që kjo pagë të tatonet dhe të ndalen kontributet, në llogarinë bankare të këtij polici do të dalin vetëm 551 euro.

Zyrtari i Policisë së Kosovës ka thënë se duke marrë parasysh rrezikun dhe mungesën e sigurimeve shëndetësore, me këtë pagë nuk ia vlen as të punohet. "Nuk është rritje kjo. Me këtë rrogë nuk ia dal as qiranë ta paguaj. Dy fëmijë i kam, gruaja nuk punon. Ata kanë thënë 619 euro, por në fund nuk dalin as aq", ka thënë ai.

Sipas këtij zyrtari, policët janë përbuzur vazhdimisht sa i takon çështjes së pagave dhe janë përdorur për mburrje nga politikanët. "Është bërë zor me këto çmime të jetosh e të mbash familje. Se di pse duhet të ndodhë kjo, kur ne, sa herë u duhemi për aksione, krejt qeveritë lëvdohe me ne. Por,

kur vjen puna te rritja e rrogave, bëjnë humor, siç kanë bërë tash me pagat", ka thënë ai.

Që nga viti 2001 në kryeje të detyrës kanë vdekur 23 zyrtarë policorë, ndërsa rreth 500 të tjerë kanë pësuar lëndime, disa prej të cilëve kanë mbetur të paafët për ta ushtruar sërish detyrën e policit.

Për shkak të kushteve të dobëta të punës, mungesës së sigurimit shëndetësor dhe pagës së ulët, Eris Jashari, pas pesë vjetësh punë si pjesëtar i Policisë së Kosovës, më 2017 ka dhënë dorëheqje nga ky institucion. Ai ka thënë se paga e tij sillet nga 430 deri në 460 euro. Jashari ka pohuar se sikur ai edhe shumë policë të tjerë janë tërhequr nga policia, pasi nuk kanë mundur të sigurojnë mirëqenie për veten dhe për familjen.

"Policët e Kosovës i kanë dy zgjedhje sot. Një të punojnë në këto kushte dhe të heshtin, sepse s'kanë të drejtë të flasin, nuk kanë të drejtë të protestojnë, nuk kanë të drejtë të bëjnë greva, nuk kanë të drejtë ta bojkotojnë punën dhe, e dyta, të dalin dhe të shikojnë alternativa të tjera jashtë vendit", ka thënë Jashari.

Jashari ka punuar në stacionin numër 3 në lagjen Kodra e Trimave në Prishtinë. Ky stacion i improvizuar ishte mbyllur pas inspektimit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUJK) për shkak se policët aty punonin në kushte minimale higjienike dhe në kontejnerë mbi 20 vjet të vjetër. Këtë stacion e kishte vizituar edhe Komisioni Parlamentar për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, i cili kishte nxitur reagim institucional për shkak të dyshimeve se kontejnerët e vjetër mund të ishin kancerogjen.

Daut Haradinaj: Ligji i Pagave nuk i përmbush kërkesat e policëve

PRISHTINË, 3 SHKURT (ER) - Anëtari i Kryesisë së Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Daut Haradinaj, ka kërkuar nga kryeministri Albin Kurti të reflektojë lidhur me pagat e

Policisë së Kosovës. Haradinaj ka thënë se trajtimi i tyre në Ligjin e Pagave nuk i përmbush nevojat që ata kanë. "Çdoherë, Policia e Kosovës është në krye të detyrës. Ne me të drejtë krenohemi me

punën e tyre. Por, trajtimi i tyre në Ligjin e Pagave as për së afërmi nuk i përmbush nevojat e tyre. Shumë prej tyre më kanë shkruar, të zhgënjyer me nivelin e trajtimit që u jep ky ligj. Edhe

pse pritej që t'u rritej paga, me ligjin e ri për shumë pjesëtarë parashihet edhe ulja. Kryeministër, reflekto", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".



SPSPK-ja kërkon nga qeveria ta caktojë pagën minimale për sektorin privat

PRISHTINË, 3 SHKURT - Sindikata e Pavarur e Sektorit Privat të Kosovës (SPSPK) në një konferencë për medie ka shprehur pakënaqësi për trajtimin e sektorit privat nga ana e Qeverisë së Kosovës. Jusuf Azemi, kryetar i kësaj sindikate, ka kritikuar qeverinë Kurti se po "sillet sikur inflacioni po i prek vetëm punëtorët e sektorit publik". Ai ka kërkuar që të ndihmohet edhe sektori privat pasi, sipas tij, buxheti i Kosovës u takon të gjithëve punëtorëve, jo vetëm atyre të sektorit publik. "Në zyrën e kryeministrit të Kosovës punëtorët që mirëmbajnë këtë zyrë paguhen 180 euro. Kjo është shumë shqetësuese për ne. Këto paga të ulëta vijnë nga Qeveria e Kosovës. Në vend se qeveria ta motivojë sektorin privat për paga më të larta, është ajo që i paguan kaq pak punëtorët teknikë. Qeveria po sillet

sikur inflacioni po i prek vetëm punëtorët e sektorit publik e jo ata të sektorit privat. Buxheti i Kosovës është buxhet i të gjithëve. Klasa më e pasur, ajo e sektorit publik, u financua, e ajo që është më e varfër jo", ka thënë Azemi.

Më tutje, Azemi ka thënë se kërkesa e sindikatës që drejton është rritja e pagës minimale në 450 euro. "Kërkesa jonë është që paga minimale të jetë 450 euro. E kemi një pagë minimale që ne mendojmë se duhet të zyrtarizohet nga qeveria. Kanë premtuar, por nuk e kanë realizuar. Kërkesë imediate jona është që të gjithë punëtorët të paguhen në përputhje të Ligjit të Pagave. Ne nuk heqim dorë. Ne jemi të Kosovës dhe i shërbejmë shtetit të Kosovës", është shprehur Azemi.

Në këtë kontekst, Azemi ka



përmendur edhe rastet e shumta të ikjes së punëtorëve nga Kosova. "92

mijë punëtorë kanë ikur nga Kosova me leje pune. Gjatë këtij viti shumë projekte do

të ndërpriten në mungesë të punëtorëve", ka deklaruar Azemi.

Abdixhiku: Koeficienti i qeverisë nuk mbulon as për së afërmi inflacionin rekord në Kosovë



PRISHTINË, 3 SHKURT - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka thënë se familjet në Kosovë janë duke u ballafaquar me vështirësi si pasojë e inflacionit dhe veprimeve jo të duhura nga ana e qeverisë për ta zbutur ndikimin e inflacionit në jetën

e tyre.

Abdixhiku këtë deklaratë e ka bërë teksa ka vizituar një familje, anëtarët e së cilës që të dy punojnë në sistemin shëndetësor. "Kafen e mëngjesit këtë të premte e piva me familjen e mrekullueshme të Lulzim e Nesibe Thaqit. Si prindër të tre

fëmijëve e në pritje të të katërtit, burim të vetëm të të hyrave kanë pagat që marrin nga sektori publik. Si punonjës shëndetësorë punë të vetme kanë kujdesin për tjetrin. Janë adresa e parë e secilit me hall. Ndërsa shteti punë të vetme duhej ta kishte kujdesin për ta. Pagat e tyre

sot vlejnë 50 për qind më pak sesa para dy vjetëve, derisa koeficienti i qeverisë nuk mbulon as për së afërmi inflacionin rekord që ka goditur familjet si kjo. Realiteti i hidhur është se historia e tyre nuk është e vetme. Kjo histori përballjeje ndahet nga familje të panumërta anembanë

Kosovës. Propozimi ynë për koeficient 125 lehtëson përballueshmërinë e familjeve si kjo. Propozimi ynë për heqje të TVSh-së në produkte bazë - bukë, miell, vaj, sheqer, qumësht e vezë - do ta bënte jetën e tyre shumë më të lehtë", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook".

Stalingrad: Akti i fundit



Më 2 shkurt 1943 përfundoi beteja më e përgjakshme e Luftës së Dytë Botërore, e zhvilluar midis gjermanëve dhe sovjetikëve. Qindra mijëra ushtarë dhe civilë vdiqën, dhe një qytet u shkatërrua totalisht në atë betejë që zgjati 1 vit e gjysmë, dhe që e ndryshoi rrjedhën e konfliktit.

Për Rajhun e Tretë, ishte disfata e parë tragjike. Kur Friedrich Von Paulus pranoi të firmoste aktin e dorëzimit, qëndroi në këmbë thujse gjatë gjithë kohës, me një dorë "të kapur" pas brezit të tij, sikur sipas dëshmitarëve "donte ta shqiste mëlçinë nga trupi". Mbrëmjen e 31 janar 1943, pra 80 vite më parë, me humbjen e një sive naziste dhe fitoren e trupave të Moskës, përfundoi beteja e Stalingradit.

700.000 gjermanë dhe gjysmë milioni sovjetikë kishin vdekur në atë pjesë të territorit rus. Dorëzimi zyrtar ndodhi më 2 shkurt. Mbi 1 mijë ushtarë të tjerë gjermanë u vranë në javët në vijim gjatë operacioneve të kërkimit.

Komandanti i aktit të fundit të luftës në anën e mbrojtësve ishte Konstantin Rokosovski, një gjeneral polak që vite më parë ishte arrestuar gjatë njërit prej "spastrimeve" të shumta të Stalinit dhe që më pas ishte rehabilituar deri në pikën që të merrte komandën e një ushtrie.

Ai i zbatoi urdhrat e tij me një zell të pazakontë, që zakonisht është tipik për një diktator, dhe fitoi nofkën "Çekiçi". Në atë moment, Lufta e Dytë Botërore ndryshoi rrjedhën e saj. Deri në atë kohë ushtria gjermane dukej e papërballueshme, por pas disfatës shkatërruese ajo nuk ishte më në gjendje t'i jepte shtysë luftës, përkundrazi nisi të pësonte humbje të tjera.

Një vit e gjysmë më parë, Adolf Hitleri kishte dhënë urdhrin për të pushtuar territoret ruse. Dhe u duk sikur divizionet e tij do ta

mposhtnin armikun brenda pak muajsh. Më 22 qershor 1941, 8 milionë ushtarë zunë pozicione: disa për t'u hedhur në sulm (3 milionë e 50 mijë nazistë dhe aleatë të tyre), të tjerët për të mbrojtur kufijtë e tyre (4 milionë e 700 mijë sovjetikë).

Në fazën e parë të ofensivës, divizionet e tankeve gjermanë Panzer dhe ato të këmbësorisë, e konfirmuan përshtypjen se ishte një fazë "luftës rrufe" të konfliktit. Komanda gjermane foli për një "goditje vendimtare". Dhe në fakt pati goditje, por jo vendimtare.

Ushtritë e blinduara të gjeneralit Hajnc Guderian (nga veriu) dhe të feldmarshallit Paul Ludvig Evald Von Kleis (nga jugu) sulmuan përtej lumit Dnjepër për të rrethuar forcat sovjetike që mbronin Ukrainën. Ata kapën mbi 10.000 robër. Ndërsa pas rënies së Kievit, 600.000 ushtarë të tjerë sovjetikë u dorëzuan tek nazistët.

Komanda ruse, e kuptoi se përballja e drejtpërdrejtë me makinën gjermane të luftës ishte e barabartë me një akt vetëvrasës. Ajo hoqi dorë nga mbrojtja deri në një fund tragjik, dhe ra dakord të tërhiqej duke përdorur si aleate hapësirat e pafundme të stepës ruse.

Tek e fundit, një shekull më parë, ajo strategji kishte rezultuar e suksesshme kundër forcave po aq mbresëlënëse të Napoleon Bonapartit. Sigurisht, nuk bëhej fjalë për t'u arratisur nga armiku. Sovjetikët organizuan një lloj luftime guerile me përmasa të mëdha. Sulmet e papritura dhe të fuqishme të rezistencës ruse, e bënë rraskapitës dhe shumë nervoz përparimin e trupave të Hitlerit.

Për shembull luftime të ashpra pati në Nikitovka, ku u përfshinë edhe njësitë italiane që Benito Musolini kishte dërguar për të luftuar përkrah ushtrive të Hitlerit

të angazhuara në Evropën Lindore. Horizonti, gjithmonë i njëjtë dhe pa jetë, dukej sikur ishte krijuar enkas për të dobësuar moralin e ushtarëve gjermanë. Shirat e vjeshtës e vështirësuan përparimin e gjermanëve, të cilët gjetën vetë një mënyrë për të shumëfishuar problemet, duke e ndarë ushtrinë në tre pjesë, dhe duke vendosur një kurs të ndryshëm marshimi për secilën. Plani ishte të pushtohej sa më shumë territor.

Por rezultati ishte që secila prej atyre pjesëve të ushtrisë gjermane, ishte më e dobët dhe më e ekspozuar ndaj armikut. Tërheqja sovjetike u ndal në periferinë e Stalingradit. Deri në atë moment ata kishin hequr dorë nga qindra kilometra katrorë, por këtu bëhej fjalë për mbrojtjen e puseve dhe vendburimeve të naftës në Maikop.

Gjermanët kishin nevojë për to, sepse furnizimet po u mbaronin. Dhe rusët e kuptuan se pengimi i tyre do të kishte një vlerë strategjike vendimtare. Më 28 korrik 1942, Josif Stalin lëshoi urdhrin e tij nr.227, që e ktheu luftën nga sulmet guerile në luftime ballore.

Diktatori sovjetik nuk ishte një njeri fliste shumë. Mjaftoi që ai të urdhëronte: "Nuk ka më asnjë hap prapa!". Lufta që pasoi e shkriu çeliku e tankeve dhe krijoi male me të vdekur.

Gjermanët që ishin një ushtri elitare u hodhën në sulm duke zbatuar një plan beteje që ishte gjithashtu shumë efektiv. Dhe në javët e para, luftimet i favorizuan sulmuesit. Ata pushtuan disa ura strategjike mbi lumin Don, ndërsa avionët e Luftwaffe-s ndaluan në periferitë e Stalingradit.

Në ushtrinë sovjetike, krahas ushtarëve, luftuan dhe gratë. Dhe ishte pikërisht një nga grupet e grave që përdorën kundër-ajrorët për të frenuar sulmet e armikut.

Në atë rast, rezultatet praktike ishin minimale, por përfaqësonin sinjalin e vullnetit për të rezistuar. Dhe ata nuk u dorëzuan edhe kur kushtet e jetesës u bënë të dëshpëruara.

Ushtarë sovjetikë vuanin nga uria, kishin pak armë pak ilaçe për të shëruar veten. Ata vazhduan të luftonin pa këmbë, edhe pasi ishin plagosur për vdekje. I sfiduan armiqtë e tyre duke u zvarritur me thikat midis dhëmbëve. U futën nën tanket gjermane për t'i hedhur në erë me eksploziv.

Jetuan si të ishin në një nga rrathët e Ferrit. "Stalingradi nuk është më një qytet. Ditën ka një re të madhe tymi verbues. Ndërsa kur errësohet, qentë kridhen në lumin Vollga, sepse nata i tmerron. Kafshët do të ishin dorëzuar, por sovjetikët rezistuan derisa nën urdhrat e gjeneralit Georgy Zhukov ishin në pozitë për të kundërsulmuar"- shkroi në ditarin e tij një ushtar rus.

Pavarësisht ushtarëve të humbur, Stalini kishte burime të shumta njerëzore. Shtabi i tij i përgjithshëm arriti të zbatonte një plan i cili me dy lëvizje nga juglindja dhe nga veriperëndimi e izoloi ushtrinë e Von Paulusit. Pesë divizione rumune u dorëzuan pa shumë rezistencë.

Të gjithë të tjerët u gjendën të bllokuar në një fushë të madhe: 284.000 burra, 100 tanke, 1.800 topa dhe 10.000 automjete. Kur u mbyll rrethimi, aty ishin edhe 79 italianë, të regjistruar si shoferë, të cilët kishin mbërritur në front me kamionë të ngarkuar me furnizime (sidomos ushqime dhe çizme).

Hitleri e nënvlerësoi rrezikun. Ndërsa Shtabi i Përgjithshëm i bëri presion duke propozuar zgjidhje taktike për të çarë rrethimin ku gjendej Von Paulus, ai vazhdoi të mbështeste tezën se do ta zgjidhte problemin me tanket "Tiger", që

ishte praktikisht gati për t'u përdorur në luftë.

Ndërkohë, bëhej fjalë për sigurimin e furnizimeve të nevojshme duke përdorur avionët dhe pilotët e gjeneralit Herman Göring. S'ka nevojë të thuhet që asnjëra nga dy nismat e imagjinuara nuk funksionoi. Komandantët kishin premtuar 700 tonë materiale ndihmë të përditshme.

Por më pas e kuptuan se mund të siguronin vetëm gjysmën e kësaj sasive. Dhe mbërriti vetëm gjysma e gjysmës: 3200 tonë në 60 ditë, me sakrifikimin e 488 avionëve, të rrëzuar nga zjarri i kundërajrorëve sovjetikë. Përpjekja e fundit erdhi nga gjenerali Erik Von Manshtein, që kishte marrë komandën e grupit të ushtrisë së "Donit".

Ai planifikoi të sulmonte nga lindja trupat sovjetike të pozicionuara rreth Stalingradit. Në të njëjtën kohë Von Paulus do të përparonte në anën perëndimore të qytetit. Në këtë mënyrë, rusët do të gjendeshin në kurth midis dy zjarreve, dhe kjo besonin gjermanët do ta thyente rezistencën e rusëve.

Operacioni do të quhej "Stuhia dimërore". Por plani mbeti thjesht i tillë. Hitleri nuk ishte aspak entuziast. Von Paulus, i goditur psikologjikisht nga një gjendje inferioriteti, nuk ishte në gjendje të mobilizonte trupat në mënyrë efektive.

Von Manshtein e tentoi gjithsesi zbatimin e planit "Stuhia dimërore", por u detyrua të ndalej 60 kilometra nga pozicionet e Von Paulus. Ky i fundit i rrethuar nga trupat armike, nuk kishte alternativë tjetër veçse të pranonte dorëzimin. Me instinktin e gjymtimit të vetes, duke i shqyer një pjesë të zorrëve./Panorama Italia - bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Lista e trajnerëve përfitues të bursave të KOK-ut

PRISHTINË, 3 SHKURT - Bordi Ekzekutiv i Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK) ka miratuar listën e bursave olimpike për trajnerë të cilët do të përfitojnë bursa mujore gjatë vitit 2023. KOK-u për herë të parë ka vendosur t'i

mbështesë edhe trajnerët të cilët janë personat kryesorë për arritjen e rezultateve kulminante të sportistëve. Përzgjedhja është bazuar në medaljet e deritashme të fituara në Lojërat Olimpike, Kampionatet Botërore,

Kampionatet Evropiane, Lojërat Evropiane, EYOF dhe Lojërat Mesdhetare. Të gjithë trajnerët janë duke ndjekur normën olimpike Paris 2024 me garuesit e tyre. Lista përbëhet nga gjashtë trajnerë: Driton Kuka,

Majlinda Kelmendi e Fatos Tabaku (xhudo), Marjolla Sallauka e Besim Brahimi (boks) dhe Shaban Ramadani (atletikë). Mbështetja totale për një vit për të gjithë trajnerët është 28 mijë euro.



Dy ndeshje sot, dy nesër në Superligën e basketbollit

PRISHTINË, 3 SHKURT - Fundjava do t'i sjellë ndeshjet e javës së 21-të në Prince Caffè Superligë, apo rrethi i tretë i garave të elitës. Takimi i parë do të zhvillohet ndërmjet Pejës dhe Rahovecit. Pejanët kanë pasur një rënie në xhirot e fundit, sidoqoftë renditen në vendin e tretë me 13 fitore e shtatë humbje, kurse "vreshtarët" janë në vendin e fundit me dy fitore e 18 humbje. "Verdhezinjtë" shihen favoritë për këtë duel, që është si parapërgatitje para duelit çerekfinal në Final 8 Kupën e Kosovës në Basketboll. Dueli i dytë i ditës së shtunë do të jetë në mes të Vëllaznimit dhe Trepçës që, po ashtu, do të përballen në çerekfinale të Kupës së Kosovës. "Kuqezinjtë" në elitë kanë tetë

fitore e 12 humbje, ndërsa mitrovicasit numërojnë 11 fitore e nëntë humbje. Të dielën do të zhvillohen dy duele mjaft interesante. Golden Eagle Ylli që u ndal pas 15 fitoreve radhazi do të përballlet me Bashkimin, që ka ngritje të formës, andaj pritet një ballafaqim shumë interesant në Therandë. Therandasit kanë 15 fitore e pesë humbje, ndërsa prizrenasit nëntë fitore e 11 humbje. Ndeshja e fundit e kësaj xhiroje është ndërmjet Sigal Prishtinës dhe Ponte Prizrenit. "Bardhekaltrit" kanë 15 fitore e pesë humbje, kurse prizrenasit kanë shtatë fitore e 13 humbje. Slida është e rëndësishme për të dyja skuadrat, që kanë ambicie të ndryshme në këtë edicion.



SUPERLIGA - JAVA 21
Të shtunën takohen:
17:00 Peja - Rahoveci
19:00 Vëllaznimi - Trepça
Të dielën takohen:
17:00 Golden Eagle Ylli - Bashkimi
19:00 Sigal Prishtina - Ponte Prizreni

Ramadani emërohet përzgjedhës i Kosovës në Futsall



Prishtinë, 3 shkurt - Agon Ramadani është emëruar përzgjedhës i Përfaqësueses A të Kosovës në Futsall. Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, të premtën i ka pritur në takim Agon Ramadani dhe Getart Hysenin, ish-lojtarë të futsallit. Ramadani dhe Hyseni ndër vite kanë dhënë kontributin e tyre në futsall duke qenë pjesë e kampionatit vendor e duke e përfaqësuar Kosovën edhe në arenën ndërkombëtare. "Pas një përvojë të gjatë në këtë sport, kryetari Ademi u ofroi hapësirë për të kontribuar edhe më tutje në futsall, por tani duke qenë të përfshirë me pozita zyrtare. Falë kontributit të dhënë si ndihmëstrajnerë në

Përfaqësueses A, i pari i FFK-së e emëroi Agon Ramadani përzgjedhës i ri. Ai në këtë pozitë e pason Arben Simitçium me të cilin kishin punuar bashkë tash e disa vjet, ndërkaq Getart Hysenin e angazhoi ndihmëstrajner, duke e bërë pjesë të ekipit përfaqësues në futsall, thuhet në njoftimin e FFK-së. Kryetari Ademi u uroi shumë suksese në detyrat e reja të dy ish-lojtarëve të futsallit dhe u kërkoi të punojnë me përkushtimin më të madh që Kosova të arrijë sa më shumë suksese. Nga ana tjetër, dy të angazhuarit falënderuan Ademi për besimin e dhënë dhe premtuan se nga përvoja dhe njohuritë e tyre do të japin më të mirën për Kosovën.

Sot fillon sezoni pranveror në volejball

PRISHTINË, 3 SHKURT - Të shtunën (sot) dhe të dielën (nesër) fillon stinori pranveror në Superligën A të Volejbollit të Kosovës në të dy konkurrencat. Ekipet kanë kryer të gjitha përgatitjet dhe

lëvizjet e nevojshme për gjatë këtij pushimi respektivisht afati kalimtar. Secila ndeshje do të jetë derbi në vete duke marrë parasysh cilësinë e ekipeve si dhe përforcimet që kanë bërë klubet. Federata e

Volejbollit e Kosovës ka njoftuar se ka rritje të ndeshjeve që do të transmetohen në Radio Televizionin e Kosovës (RTK), në të dy konkurrencat, meshkuj dhe femra.

Gjithashtu, FVK-ja u uron suksese të gjitha ekipeve të përfshira dhe kompetitivitet sportiv të fortë, siç i kanë karakterizuar gjithmonë ndeshjet në volejbollin e Kosovës.



Ndongbwo, MVP e javës me 20 pikë e 20 kërcime

Prishtinë, 3 shkurt - Në mesjavë u zhvillua xhiroja e tetë në Ligën Unike të Femrave. Basketbollistja më e dalluar ishte Liliane Ndongbwo e Flamuritit me dyshifrorë të dyfishtë prej 20-

pikësh e 20-kërcimesh, ndërsa ndaj Tiranës kishte edhe tri asistime. Kjo është hera e parë për të që shpallet MVP e javës në Ligën Unike. Ndërkohë, ajo u ndihmua nga MVP e mëhershme, Sophia

Jacobson, me 21 pikë, nëntë kërcime dhe pesë asistime. Bashkimi shënoi fitore të rëndësishme ndaj Penzës, ku më e mira edhe kësaj radhe ishte Khadija Brown me 24 pikë, gjashtë kërcime dhe tri

asistime. Prishtina mundi Partizanin në udhëtim, ku u dalluan Besjana Martinaj me 20 pikë, një kërcim, tri asistime, si dhe Sarah Mgbeike me 16 pikë, 13 kërcime dhe një asistim.



Messi: Nuk po u lutesha Maradonës dhe nënës, por Zotit

PARIS, 3 SHKURT - Lionel Messi, kampion i Botës, rikthehet të flasë për suksesin në Katar. Në një intervistë të gjatë për Ole, "pleshti" preku disa nga çastet më pikante nga festimet te raporti me Mbappen dhe deri tek e ardhmja. "Lutjet në penalltinë e fundit? Thuhet se po flisja me nënën time apo me Maradonan, por nuk është kështu, thjesht po i lutesha Zotit që të shënonim te penalltia e fundit, të mos zgjatej më shumë agonia", ka thënë Messi, i cili më pas e ka komentuar foton me Kupën e Botës. "Arritëm në hotel në orët e para të mëngjesit, De Paul dhe Otamendi më dëgjuan që shkova në tualet dhe erdhën në dhomë duke më bërë foto. Kupa ishte me mua atë natë. Festimet? Njerëzit e përjetuan në maksimum këtë sukses, jo vetëm pas finales, festuan me ditë të tëra. T'i shihje imazhet e tyre ishte diçka spektakolare", ka deklaruar argjentinasia Messi.

Më pas Leo Messi foli edhe për takimin me Mbappen në Paris, duke thënë se nuk kanë biseduar



shumë rreth finales në Botëror: "Folëm shkurtimisht për mënyrën se si u festua në Argjentinë, asgjë më shumë. Edhe unë kam humbur një finale Botërori, e di se çfarë do të thotë, kështu që e kuptoj dhe nuk dua ta zgjas më shumë këtë argument. Mes meje dhe tij çdo gjë shkon shumë mirë". "E ardhmja? Jam 36-vjeçar, e kam të vështirë të mendoj për Botërorin e ardhshëm, më duket e vështirë të jem. Unë e dashuroj futbollin. Për

sa kohë do të jem në formë do të vijoj të luaj, por nuk arrij dot të mendoj deri në Botërorin e ardhshëm", ka shtuar Messi. Në fund Messi e komentoi edhe rinovimin e kontratës së trajnerit Scaloni me Argjentinën. "Shpresoj që të rinovojë. Do të ishte diçka e bukur nëse nuk ndryshojmë tani. Nuk kam folur së fundmi me të, por ky është një vendim që i takon vetëm atij. Në çdo rast do ta mirëkuptoj", u shpreh Messi.

Denveri mposhti kampionët e Golden States, fitojnë edhe Bucksit dhe Lakersat

DENVER, 3 SHKURT - Denveri konsolidon kreun e renditjes në Konferencën e Perëndimit pas fitores së thellë 134-117 ndaj kampionëve në fuqi të Golden States. Gjashtë lojtarë të Denverit realizuan mbi 17 pikë, ku u dalluan Murray me 33 pikë e Nikola Jokiqi me një "triple double" (22 pikë, 14 rebounde e 16 asistime). Për Warriorsin, Curry realizoi 28 pikë, por që s'mjaftuan për të fituar. Fitore në frymën e fundit për Lakersat, që mundën me rezultat 112-111 Indianan jashtë fushës. Davisi me 31 pikë e 14 rebounde si dhe Jamesi me 26 pikë ishin më të mirët në fushë për kalifornianët. Moment të mirë po kalon



Milwaukee, që mposhti 106-105 Clippersat, ndeshje e vendosur në fundin e saj. Ndeshje e jashtëzakonshme për Antetokounmpo, që realizoi 54 pikë e 19 rebounde. New Orleans ka hyrë në krizë, duke pësuar humbjen e dhjetë radhazi, pasi u mund me rezultat 111-106 nga

Dallasi. Për teksanët u dallua Luka Donçiqi me 31 pikë. Ekipi i New Yorkut, falë 30 pikëve të Barrett e 23 pikëve të Randles, mundi 106-104 Miamin (Adebayo 32 pikë). Chicago mposhti me rezultat 114-98 rivalët e Charlottes, ku protagonist ishte stoli, nga ku erdhën 42 pikë për Bulls-in.

REZULTATET

Indiana - Lakers	111-112
Cleveland - Memphis	128-113
New York - Miami	106-104
Chicago - Charlotte	114-98
Dallas - New Orleans	111-106
Denver - Golden State	134-117
Milwaukee - Clippers	106-105

Martinelli rinovon kontratën me Arsenalin

Gabriel Martinelli e ka rinovuar kontratën me skuadrën e Arsenalit.

Braziliani nënshkroi kontratën e re e cila do ta mbajë atë në Londër deri në

qershor të vitit 2027, me mundësinë e zgjatjes edhe për një vit tjetër. Martinelli

erdhi në Arsenal në vitin 2019 dhe e ka dëshmuar veten si një lojtar mjaft i

vlefshëm për "Topçinjtë", të cilët janë në krye të renditjes tabelore.

SHKURT

Januzaj edhe zyrtarisht në Istanbul Basaksehir

Adnan Januzaj edhe zyrtarisht ka nënshkruar me Istanbul Basaksehirin.

Januzaj do të jetë pjesë e Istanbul Basaksehirit në formë huazimi deri në fund të edicionit aktual. Lajmi është konfirmuar nga klubi turk, i cili i uroi mirëseardhje futbollistit me prejardhje shqiptare. Adnan Januzaj së fundmi ishte pjesë e Sevillës, por që nuk arriti ta tregonte veten.

Reali në 'ankth', lëndohen Militao dhe Benzema

Real Madridi mori tri pikë në ndeshjen ndaj Valencias, por mori dy lajme të këqija para ndeshjes në Ligën e Kampionëve kundër Liverpoolit. Fjala është se futbollistët Karim Benzema dhe Eder Militao kanë pësuar lëndime dhe mund të jenë mungesa për këtë ndeshje. Mbrojtësi brazilian doli nga fusha e lojës pas vetëm 36 minutash lojë, kurse më shqetësues është situata e Benzemas, i cili ka vendosur në ankth Ancelottin, pasi e la fushën e lojës për shkak se pati dhembje në kofshë.

Kaka, Leaos: Mos u largo nga Milani

Shumë klube evropiane janë të interesuara për yllin e Milanit, Rafael Leao. Portugezi ende nuk e ka rinovuar kontratën me skuadrën kuqezi edhe pse drejtuesit e italianëve po bëjnë maksimumin për ta bindur të qëndrojnë në "San Siro". Së fundmi, në lidhje me të ardhmen e Leaos foli edhe një legjendë e Milanit si Ricardo Kaka. "Leao është nga ata lojtarë që mund ta ndryshojnë ndeshjen në çdo moment. Një lojtar fantastik që mua më pëlqen shumë, por nëse e sheh futbollin italian si një skenë kalimtare atëherë bën mirë të largohet sa më shpejt. Mendoj se është në momentin më të mirë për të lëvizur. Por, unë e këshilloj të qëndroj sepse nuk e shoh futbollin italian si të lënë pas dore dhe, përveç kësaj, ndonjëherë të largohesh nga Milani thjesht nuk është zgjedhja e duhur", ka thënë Kaka.

40 shtete mund ta bojkotojnë Olimpiadën e Parisit

Ministri i Sportit dhe Turizmit në Poloni, Kamil Bortniczuk, ka thënë se deri në 40 shtete mund t'i bojkotojnë Lojërat Olimpikë të Parisit, diçka që do ta bënte krejtësisht të pakuptimtë ngjarjen e madhe sportive. Deklarata e tij erdhi pasi Polonia, Lituania, Estonia dhe Letonia refuzuan bashkërisht planin e Komitetit Ndërkombëtar Olimpik për t'i lejuar sportistët rusë dhe bjellorusë të marrin pjesë në turneun e vitit 2024. Ukraina sigurisht që ka kërcënuar me bojkot nëse kjo ndodh, por KON tha të enjten se bojkoti do t'i ndëshkonte vetëm sportistët.

Bortniczuk ka deklaruar se besonte që ishte e mundshme që Polonia të ngrrej një aleancë me 40 shtete të tjera, përfshirë Britaninë e Madhe, Shtetet e Bashkuara dhe Kanadanë, për t'i kundërshtuar planet e KON-it para mbledhjes së 10 shkurtit. "Nëse ne e bojkotojmë Olimpiadën, atëherë ajo do të ishte e pakuptimtë", ka thënë Bortniczuk.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Taverna Jonë” - Sh.P.K, ka marrë vendim të shuajë biznesin me NUI: 811548918 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë me këtë kompani që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Taverna Jonë” - d.o.o., donelo odluku o prestani rada sa bisnisom NUI: 811548918 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that “Taverna Jonë” - L.L.C, has taken the decision to quit its business with NUI: 811548918, The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor – debtor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “VicanaTech” - Sh.P.K, ka marrë vendim të shuajë biznesin me NUI: 811925364 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë me këtë kompani që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “VicanaTech” - d.o.o., donelo odluku o prestani rada sa bisnisom NUI: 811925364 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that “VicanaTech” - L.L.C, has taken the decision to quit its business with NUI: 811925364, The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor – debtor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT**SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Mërgim Veseli shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së dhjetë të shkollës së mesme “28 Nëntori” Prishtinë.

- Zain Skenderi shpall te pavlefshme dëftesën e kl I - VIII shfmu " Lidhja e Prizrenit " Prizren.

- Arlind Gashi shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren .

- Isuf Avdyli shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Bajram Curri " Krushe e Madhe.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULË

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues